



**Vendimi Nr.122/23**

**Datë: 21.12.2023**

Duke u bazuar në nenin 11,13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, i Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 21.12.2023, mori këtë;

**V E N D I M**

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve Teak Capital BV dhe Tangor Capital S.A., lidhur me blerjen e aksioneve dhe marrjen e kontrollit të përbashkët mbi NIH VI VOV Holdings S.a.r.l. (Ndërmarrje e Synuar)

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

**Arsyetim**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 25.10.2023, ka pranuar kërkesën për Përqendrim me Nr. Prot. 504/23-11/H, lidhur me blerjen e aksioneve dhe marrjen e kontrollit të përbashkët nga ndërmarrjet Teak Capital BV dhe Tangor Capital S.A., mbi NIH VI VOV Holdings S.a.r.l. (Ndërmarrje e Synuar).

**Procedurat e ndjekura:**

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 23.11.2023
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 24.11.2023
3. Marrëveshjen e nënshkruar mes palëve për shit-blerje të Aksioneve, e lidhur me datë 11 tetor 2023, në bazë të së cilës të dy Aplikuesit do të blejnë secili nga 50% të aksioneve dhe do të marrin kontrollin e përbashkët mbi Ndërmarrjen e Synuar.

**Teak Capital BV**, është shoqëri aksionare dhe ekzistuese sipas ligjeve të Holandës, me numër të regjistrimit të biznesit 64716244 dhe adresë të regjistruar në Basisweg 10, 1043 AP Amsterdam, Holandë. Aktivitetet e ndërmarrjes është investime në sektorët industrial, financiarë të pasurive të paluajtshme, arsimit dhe shëndetësisë. Teak Capital BV është pjesë e grupit të ndërmarrjeve, Teak Grup.

**Tangor Capital S.A.**, është një shoqëri aksionare e organizuar, sipas ligjeve të Republikës së Portugalisë, me numër të regjistrimit të biznesit 507.197.836 dhe adresë të regjistruar në Rua de Cabo Verde, nr. 37, 4150-159 Porto, Portugali. Aktiviteti i ndërmarrjes është investimi në sektorët industrial, financiarë, të pasurive të paluajtshme dhe arsimore, ndërmarrja është pjesë e grupit të kompanive Tangor me bazë portugeze.

**NIH VI VOV Holdings S.a.r.l**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar sipas ligjeve të Luksemburgut, me numër të regjistrimit të biznesit B218369 dhe adresë të regjistruar 124, Boulevard de la Petrusse, L-2330. Aktiviteti i ndërmarrjes është prodhimi i dyerve të presuara për makina larëse dhe tharëse, produkte për pjekjeje me cilësi të lartë, si dhe kallëpe për injektim për xham të presuar dhe termoplastike.

#### **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim në tregun e brendshëm ka mbi 1,000,000 Euro.
3. Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen e arritur me datë 11 tetor 2023.

#### **Analiza e Konkurrencës:**

Ndërmarrja e synuar (NIH VI VOV Holdings S.a.r.l.) dhe parashtruesit e kërkesës nuk realizojnë shitje në tregun e Republikës së Kosovës si dhe nuk kanë ndonjë filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës. Kërkesa për transaksion në Kosovë, është bërë për arsye se aplikuesit kanë një pjesë të vogël të aksioneve në, BA Glass BV, ndërmarrje Bullgare, që gjeneronë të ardhura përmes distributorit të autorizuar dhe shitjeve në tregun e Kosovës. Palët në përqendrim nuk kanë mbivendosje horizontale apo vertikale, ndërmjet aktiviteteve afariste, të palëve në Kosovë, prandaj transaksioni nuk do çojë në, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin ose forcimin e pozitës dominuese, pra nuk do të shkaktojë efekte negative në treg si dhe të konsumatorët në Republikën e Kosovës,

### **Tregu Përkatës:**

**Tregu i produktit**, përkufizohet si treg për prodhimin e qelqit të presuar për përdorim industrial, dyer xhama, për makinat larëse dhe tharës si dhe enë pjekje të xhamit në tërë botën, pasi që Grupi i ndërmarrjes së Synuar ka shitje të konsiderueshme, në botë.

**Tregu gjeografik**, do të përkufizohet si treg ndërkombëtarë pasi që pala operon në tërë botën.

### **Efektet e konkurrencës ne tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar**

Transaksioni i propozuar do të realizohet kryesisht në tregun gjeografik të Luxembourg. Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se Aplikuesit në përqendrim kanë qarkullim përmes BA Glass BV, ndërmarrje Bullgare. Ndërmarrja Teak, ka një pjesë të vogël aksionesh në BA Glass, që gjeneron të ardhura përmes një distributori dhe përmes shitjeve në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, prandaj nuk vërehen indikacione të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës në Republikën e Kosovës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

### **Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje antikonkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

## KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva